



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:296381
Datë: 13.11.2024
Numri i dokumentit: 06443958

C.nr.811/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike të paditësve A.K nga fshati Xërxë, M.O nga Rahoveci, V.P-K nga fshati Ratkoc dhe Z.B nga fshati Bellacërkë, Komuna Rahovec, të cilët i përfaqëson Av. D.M nga Prizreni rr. "...., kundër të paditurës Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale për Arsim, lidhur me kompensimin e ushqimit në punë, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seance, më datë 13.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësve A.K nga fshati Xërxë, M.O nga Rahoveci, V.P-K nga fshati Ratkoc dhe Z.B nga fshati Bellacërkë, Komuna Rahovec, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale për Arsim, lidhur me kompensimin e ushqimit në punë.

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësit A.K nga fshati Xërxë, M.O nga Rahoveci, V.P-K nga fshati Ratkoc dhe Z.B nga fshati Bellacërkë, Komuna Rahovec, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar, ka ushtruar padinë kundër të paditurës Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale për Arsim, lidhur me kompensimin e ushqimit në punë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses Av. D.M nga Prizreni me parashtrësë të veçantë të datës 08.11.2024, e ka tërhequr padinë.

Andaj, kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësit është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.811/2024, më 13.11.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.